

Nr. Prot. 043/B/17

Nr. i Regjistrimit: 33

**RREGULLORE****PËR****BARTSHMËRINË E NUMRAVE PËR PARAPAGUESIT E SHËRBIMEVE  
PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE**

Kjo rregullore është nxjerr në bazë të nenit 1, nenit 3 paragrafi 1), nenit 9, paragrafi 3), pika 2 dhe 3, nenit 10 paragrafi 4), nenit 60, nenit 64, nenit 85 paragrafi 7 pika 3.2, i Ligjit Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si -Ligji*); Direktivës 2002/22/EC të Këshillit dhe Parlamentit Europian të datës 7 Mars 2002 për shërbimet universale dhe të drejtat e përdoruesve të rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (*Direktiva e Shërbimeve Universale*), të ndryshuar me Direktivën 2009/136/EC të datës 25 Nëntor 2009.

**Neni 1****Qëllimi dhe Fushëveprimi**

- 1.1 Kjo Rregullore përcakton termat dhe kushtet, të cilat duhet të plotësohen nga operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për të ofruar mundësinë e bartshmërisë së numrit. Kjo rregullore gjithashtu përcakton masat për të realizuar lehtë dhe shpejtë procesin e kalimit më të mirë të parapaguesit ndërrues.
- 1.2 Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i zbatimit të bartshmërisë së numrave nga të gjithë operatorët, të cilët ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike mobile dhe/ose fikse si dhe krijimin e kushteve më të mira për rritjen dhe mbrojtjen e konkurrencës.

**Neni 2****Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje;

- 2.1 Kuptimi apo definicioni i cilësdo fjalë, frazë apo shprehje sipas Ligjit do të jetë gjithashtu i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë Rregullore;
- 2.2 Termat dhe shprehjet në vijim do të kenë këtë kuptim:
  - a) **ARKEP** - nënkupton Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

- b) **Parapagues** - nënkupton cilindo person fizik apo person juridik, i cili ka lidhur një kontratë me një ndërmarrës që ofron shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun për përfitimin e shërbimeve të ofruara.
- c) **Parapaguesi Ndërrues:** nënkupton parapaguesin, i cili bënë kërkesë për bartjen e numrit.
- d) **Parapaguesi Pre paid** – është konsumator i shërbimeve me parapagim.
- e) **Operatori Donator:** është operatori i rrjetit, të të cilit i takon numri mobil dhe/ose fiks në kohën që Parapaguesi bën një kërkesë për bartje.
- f) **Operatori Pranues:** është operatori, i cili do të ofron shërbimet e komunikimeve elektronike tek Parapaguesi pas bartjes.
- g) **Operatorit të cilit i është caktuar blloku i numrave:** është operatori, të cilit ARKEP i ka caktuar me vendim bllokun e numrave që përmban numrin/at i/e bartur.
- h) **Bartja e numrit:** nënkupton realizimin e bartshmërisë së numrit me kërkesë të parapaguesit.
- i) **ETSI** - është Instituti European i Standardeve Telekomunikuese.
- j) **All Call Query (ACQ)** - është një metodë që përcakton se rrjeti origjinues, para vendosjes së çdo thirrje, përcakton rrjetin, në të cilin numri i thirrur është i vendosur aktualisht duke kërkuar një pasqyrë lokale të bazës së të dhënave referuese.
- k) **Query on Release** - është një metodë e rrugëtimit të thirrjes në numrat e bartur, përmes së cilës rrjeti origjinues para vendosjes së thirrjes, e dërgon një kërkesë për vendosjen e thirrjes në drejtim të rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit donator.
- l) **Baza Qendrore Referuese e të Dhënave (CRDB)** - është një bazë e të dhënave, e cila ruan gjendjen e secilit transaksion gjatë procedurës së bartjes së numrit dhe përmban informatat e nevojshme për rrugëtimin e thirrjes në drejtim të numrit të bartur. Të gjitha këto informata përditësohen në kohë reale edhe për bazat lokale të operatorëve.
- m) **Kostot e konfigurimit për linjë ose numër:** janë kosto shtesë që ndodhin vetëm një herë për të bartur një ose më shumë numra përveç koston së bartjes së parapaguesit tek një operator tjetër pa bartshmëri të numrit ose për të ndaluar shërbimet e komunikimeve elektronike.
- n) **Kostot shtesë të bartjes për bartshmërisë e numrit:** janë kosto shtesë të shkaktuara në rrjet tek numrat e bartur në krahasim me numrat që nuk janë të bartur; ato mund të përfshijnë kostot e transitit, (sinjalizimit) dhe kërkimit në bazën e të dhënave.

- o) **Kostot e kërkimit në bazën e të dhënave:** janë kosto të shkaktuara nga operatori për çdo telefonatë në një numër të bartur ku përdoret baza e të dhënave e cila përmban informacionin e rrugëtimit (routing).
- p) **Kostot vjetore të bazës qendrore referuese të të dhënave:** janë kosto totale për të instaluar dhe mirëmbajtur, operuar dhe menaxhuar bazën qendrore referuese të të dhënave për bartshmërinë e numrit.
- q) **Peroudha e Skadencës (Ageing)** - është afati kohorë brenda të cilit një numër telefonik nuk mund t'i caktohet dhe përdoret nga parapaguesit për të shmangur thirrjen e gabuar.
- r) **Onward Routing** - Kjo do të thotë se në qoftë se thirrja i përcillet operatorit, të cilit i'u është caktuar blloku i numrave që më pas operatori e detekton se thirrja është bartur, merr informacionet mbi rrugëtimin dhe përcjell thirrjen në drejtim të operatorit pranues.

## KAPITULLI I PARIMET E PËRGJITHSHME

### Neni 3 Ndikimi mbi Planin e Numeracionit

- 3.1 Numrat gjeografik mund të barten vetëm në kuadër të hapësirës së njëjtë gjeografike të numeracionit.
- 3.2 Operatori pranues përdor numrat e bartur për të ofruar shërbimet e tij. Ai është përgjegjës për shfrytëzimin e numrave të bartur.
  - 3.2.1 Numrat e bartur mund të përdorën vetëm sipas rregullave dhe parimeve të përcaktuara në Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës të miratuar nga ARKEP (*tutje referuar si - Plani i Numeracionit*).
- 3.3 Operatori, të cilit i është caktuar blloku i numrave është përgjegjës për pagesën e të gjitha tarifave ashtu siç është përcaktuar me Planin e Numeracionit.
  - 3.3.1 Në qoftë se diferenca në mes numrave të pranuar (ported in) dhe numrave të bartur (ported out) është më e madhe se 1,000 numra, operatori të cilit i është caktuar një bllok i numrave gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrë proporcionale ashtu siç janë caktuar tarifatat nga Planin e Numeracionit.
- 3.4 Nëse kontrata në mes operatorit pranues dhe parapaguesit përfundon dhe numri nuk është subjekt i një bartje të mëvonshme, atëherë për të shmangur thirrjet e gabuara numri kthehet pas një periudhe kohore prej minimum tre (3) muaj dhe maksimumi gjashtë (6) muaj tek operatori, të cilit i është caktuar blloku i numrave. Operatori pranues gjatë kësaj periudhe duhet të informojë pa pagesë thirrësin se Parapaguesi nuk është i qasshëm përmes këtij numri.

3.5 Operatori është i detyruar që të ofrojë një “beep tone” para thirrjes për “thirrjet e bartura jasht rrjetit”.

#### **Neni 4 Rastet e përjashtuara**

4.1 Bartshmëria e numrit nuk mund të kërkohet për numrat:

- a) të cilat janë pjesë e një blloku të numrave që nuk është caktuar nga ARKEP;
- b) nuk është bërë thirrja e parë për parapaguesit mobil me parapagim (*pre-paid*);
- c) në periudhën të skadencës;
- d) që janë përdorur nga parapaguesit, të cilët nuk e kanë paguar borxhin.

4.1.1 Pas pranimit të kërkesës për validimin e bartjes së numrit nga operatori donator, operatori pranues ka të drejtën të ndryshoj statusin e parapagimit në *pre-paid* për të shmangur borxhin.

4.2 Parapaguesit e telefonisë fikse me numra gjeografik, kanë po ashtu të drejtë të bartin numrat në qoftë se ata mund të dëshmojnë se ata janë caktuar nga operatori si numër i rezervuar për atë parapagues.

### **KAPITULLI II KËRKESAT TEKNIKE DHE OPERATIVE**

#### **Neni 5 Parimet e përgjithshme**

5.1 Operatorët janë të lirë të vendosin vet për arkitekturën e rrjetit të tyre, funksionet e rrjetit dhe specifikimet tjera, përveç atyre në ndërfaqet e përbashkëta (interfaces) siç është përcaktuar në paragrafin 5.1.1) të këtij neni.

5.1.1 Pas konsultimit publik, ARKEP përcakton specifikimet mbi ndërfaqet e përbashkëta për sinjalizim, përshkrimin e arkitekturës së rrjetit, procedurat operacionale në përputhje me Kapitullin III të kësaj Rregulloreje dhe marrëveshjet mbi nivelin e shërbimeve. Arkitektura e sinjalizimit dhe rrjetit do të bazohet në specifikacionet e ETSI-it.

5.1.2 Specifikimet siç përcaktohen në paragrafin 5.1.1) të këtij neni publikohen në ueb faqen e internetit të ARKEP-it.

#### **Neni 6 Metoda e Rrugëtimit**

6.1 Çdo operator, të cilit i është caktuar blloku i numrave ka për obligim të ofrojë “*onward routing*” minimal, si metodë të rrugëtimit. Kjo do të thotë se në qoftë se thirrja i përcillet operatorit, të cilit i’u është caktuar blloku i numrave që më pas operatori e detekton se

thirrja është bartur, merr informacionet mbi rrugëtimin dhe përcjell thirrjen në drejtim të operatorit pranues.

6.2 "All Call Query" dhe "Query on Release" janë metoda opsionale të rrugëtimit.

### **Neni 7**

#### **Baza Qendrore Referuese e të Dhënave**

- 7.1 Të gjithë operatorët që përdorin numrat mobil sipas Rekomandimit E.164 për të ofruar shërbime publike të komunikimeve elektronike mobile janë të obliguar të përdorin bazën qendrore referuese të të dhënave (CRDB) për bartshmërinë e numrit. CRDB mbështet proceset operacionale dhe përmban informacionin e nevojshëm të rrugëtimit të thirrjeve tek numrat mobil të bartur.
- 7.2 Të gjithë operatorët, cilat përdorin numrat fiks (gjeografik dhe jo-gjeografik) E.164 për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike publike fikse, janë të lejuar të përdorin proceset e ndërsjella dhe shpërndarjen e ndërsjellë të informacioneve të rrugëtimit.
- 7.3 Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe shërbimet e emergjencës duhet të kanë qasje pa pagesë (përmes internetit) në CRDB dhe në bazat e të dhënave të operatorëve individualë të linjave fikse, të cilat përmbajnë informacionin e rrugëtimit. Të gjitha informatat do të ruhen minimum gjashtë (6) muaj.
- 7.4 CRDB do të menaxhohet nga ARKEP.
- 7.5 ARKEP do të zgjedh një partner operativ për zhvillimin dhe operimin e përditshëm të CRDB.

## **KAPITULLI III**

### **PROCESET ADMINISTRATIVE TË BARTJES**

#### **Neni 8**

##### **Parimet Themelore**

- 8.1 Për bartjen e një numri, duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:
- a) kërkesa e parapaguesit tek operatori pranues;
  - b) kërkesa për t'u vërtetuar bartja e numrit nga operatori pranues;
  - c) marrëveshja/pëlqimi i donatorit për të bartur numrin;
  - d) instalimi dhe ose aktivizimi i linjës, të shoqëruar me bartjen aktuale të numrit.
- 8.2 Parapaguesi, i cili kërkon bartjen e numri të tij nënshkruan një dokument të shkruar apo elektronik, i cili është paraqitur në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje (të quajtur "Autorizimi"), ku:
- a) e identifikon veten e tij në mënyrë të qartë përmes një dokumenti të vlefshëm identifikimi;

- b) autorizon operatorin pranues për të ndërmarr të gjitha hapat e nevojshëm viza-vijë operatorit donator për të bartur numrin e tij;
  - c) autorizon operatorin pranues për të ndërmarr të gjitha hapat e nevojshëm viza-vijë operatorit donator për të ndërprerë kontratën ose lidhjen komerciale me donatorin;
  - d) është informuar se në rast të abonimit mobil me parapagim (pre-paid), parapaguesit do të humbasin kreditin;
  - e) është i informuar se Parapaguesi duhet të respektojë kushtet dhe afatet e kontratës, dhe se Parapaguesi mund të jetë subjekt i një dënimi;
  - f) gëzon të drejtën në kompensim në rast të vonesës ose abuzimit.
- 8.3 ARKEP ka të drejtë të kontrollojë dhe të bëjë ndryshime në Autorizim për të siguruar pajtueshmërinë me këtë rregullore.
- 8.4 ARKEP ka të drejtë të kërkojë Autorizimin për çdo kërkesë për bartjen e numrit me një njoftim paraprak prej dy (2) ditëve të punës, në mënyrë që të kontrollojë ankesat e parapaguesve (p.sh. marrjen e numrit telefonik pa paralajmërim - slamming), ose për të verifikuar pajtueshmërinë me këtë rregullore.
- 8.5 Operatori donator nuk ka të drejtë të kërkojë Autorizimin. Autorizimi duhet të ruhet nga operatori Pranues për një periudhë prej së paku gjashtë (6) muaj pas datës së nënshkrimit.
- 8.6 Parapaguesi ka të drejtë në përputhje me nenet 9.4, 9.5, 9.6, 10.2 dhe 10.3 të kësaj rregulloreje, të zgjedh ditën për bartjen e numrit. Nuk ekziston asnjë obligim që kjo datë të shoqërohet me ndërprerjen e kontratës me operatorin donator.
- 8.7 Nëse operatori pranues fillon procesin e bartjes pa autorizimin e parapaguesit, atëherë operatori donator dhe parapaguesi kanë të drejtë që të kërkojnë kompenzim. Në rast se numri është bartur, atëherë numri do të kthehet pas tek operatorin donator.

## **Neni 9 Faza e Validimit**

- 9.1 Pas nënshkrimit të Autorizimit, operatori pranues i dërgon përmes bazës qendrore referuese të të dhënave (CRDB) në rast të numrit mobil ose direkt në rastin e numrave fiks, një kërkesë për të validuar bartjen e numrit.
- 9.2 Validimi i realizuar nga operatorin donator mund të dështojë vetëm nëse parapaguesi do të dëmtohet nëse vazhdohet me këtë proces. Çdo refuzim i validimit duhet të jetë i arsyetuar dhe i specifikuar në procesin operacional.
- 9.3 Pavarësisht nga paragrafi 9.2) një operator donator nuk mund të refuzojë si të pavlefshme kërkesën për bartjen e një numri për shkak të:

- a) borxheve të këqija të parapaguesit;
- 9.4 Afati i mëposhtëm maksimal kohor për validim të bartjes së numrit duhet të respektohet për 95% të të gjitha rasteve:
- a) për Parapaguesit e biznesit në rrjetin mobil me kontratë/post-paid (zakonisht shumë numra): maksimum tri (3) ditë pune;
  - b) për Parapaguesit fizik në rrjetin mobil me kontratë/post-paid (1 numër) dhe atyre me parapagim/Pre-Paid: maksimum një (1) ditë pune;
  - c) për Parapagues/konsumator biznesi në rrjetin fiks (zakonisht një varg DDI): maksimum tri (3) ditë pune;
  - d) për Parapagues/konsumator person fizik në rrjetin fiks (1 numër): një (1) ditë pune.
- 9.5 Pjesa e mbetur prej 5% të kërkesës për validim mund të kenë vonesë maksimale shtesë prej një (1) ditësh në krahasim me afatin kohor të specifikuar në paragrafin 9.4) të këtij neni. Periudha referente për të llogaritur këtë parametër është një (1) vit.
- 9.6 Një ditë pune fillon nga e hëna deri të premten (8:00 deri 16:00) me përjashtim të festave dhe fundjavës. Dita kur kërkohet validimi nuk konsiderohet të jetë pjesë e periudhës në fjalë.
- 9.7 Në përputhje me nenin 5.1.1 të kësaj rregulloreje, detajet e procesit të validimit do të përshkruhen në specifikimet operationale.
- 9.8 Gjatë 2 muajve të parë pas implementimit të bartshmërisë së numrave, sasia e numrave që mund të barten mund të kufizohet nga ARKEP. Pas kësaj periudhe nuk lejohet kufizim i sasisë së numrave, të cilët mund të barten.

## **Neni 10**

### **Aktivizimi i bartjes të numrit**

- 10.1 Statusi i aktivizuar është kur një Parapagues, i cili e bartë numrin e tij mund të bëjë dhe pranojë thirrje nga të gjitha rrjetet.
- 10.2 Menjëherë pas instalimit ose aktivizimit të linjës fikse, operatori pranues do të fillojë me kërkesën për bartjen e numrit. Koha maksimale që Parapaguesi i linjës fikse nuk mund të arrihet është një (1) ditë pune për 95% të të gjitha bartjeve të numrave dhe dy (2) ditë pune për 100% të të gjitha bartjeve të numrave.
- 10.3 Pas pranimit të kërkesës për bartjen e numrit mobil nga operatori pranues, operatori donator do të deaktivizoj numrin nga rrjeti i tij. Më pas operatori pranues do të aktivizoj numrin në rrjetin e tij. Parapaguesi do të jetë në dijeni se nuk pranon tani e tutje shërbime nga operatori donator dhe so të ndëroj SiM kartelën. CRDB do të përditësoj informacionet e rutimit. Koha maksimale që Parapaguesi mobil nuk mund të



arrihet është 60 minuta për 95% të të gjitha bartjeve të numrit dhe 120 minuta për 100% të të gjitha bartjeve të numrit. Periudha referente për të llogaritur këtë parametër është 1 vit.

10.3.1 Në përputhje me nenin 5.1.1 të kësaj rregulloreje, detajet e procesit të validimit do të përshkruhen në specifikimet operacionale.

## **Neni 11**

### **Kompensimi për Parapaguesit**

11.1 Parapaguesit me kërkesë të tyre gëzojnë të drejtën në kompensime të mëposhtme në rast të vonesës në bartjen e numrit:

- a) për pakot me Kontratë dhe Parapagim në rrjetin mobil si dhe linjës fikse (person fizik): një (1) euro për një ditë vonesë;
- b) për pakot me Kontratë dhe Parapagim në rrjetin mobil si dhe linjës fikse (kompanitë): një euro e gjysmë (1.5) euro për një ditë vonesë.

11.2 Për kartelat e pakos “*Pre-paid*” lejohet të bëhet kompensimi në formën e kredive shtesë.

11.3 Kompensimi i përgjithshëm është kompensimi në ditë i shumëzuar me numrin e ditëve të punës, për të cilat është vonuar bartja.

11.4 Vonesa fillon kur një bartje e numrit nuk është aktivizuar brenda një (1) dite pune:

- a) pas datës së dërgimit të kërkesës për validimin e bartjes së numrit për rastet e specifikuar në paragrafin 9.4.b, nëse parapaguesi dëshiron që numri i tij mobil të bartet menjëherë ose pas datës së bartjes siç është rënë dakord ndërmjet operatorit pranues dhe parapaguesit për numrat mobil;
- b) pas datës për fillimin e procesit të bartjes së numrit mobile nga operatori pranues për rastet e specifikuar në paragrafin 9.4.a, nëse parapaguesi dëshiron që numri i tij mobil të bartet menjëherë ose pas datës së bartjes siç është rënë dakord ndërmjet operatorit pranues dhe parapaguesit për numrat mobil.
- c) pas datës së instalimit dhe aktivizimit të linjës fikse për numrat fiks.

11.5 Operatori pranues është përgjegjës për trajtimin administrativ të ankesës dhe pagesën e kompensimit.

11.5.1 Operatori pranues mund të bëjë ankesë për dëmtim nga operatori i cili është shkaktar i vonesës.

11.5.2 Në rast të abuzimit, ARKEP do të përcaktojë kompensimin për parapaguesin që do të paguhet nga operatori, i cili është shkaktar i abuzimit ndaj ankuesit.

## **KAPITULLI IV**

### **ASPEKTET FINANCIARE**



**Neni 12**  
**Tarifat për bartshmërinë e numrit për parapaguesin**

- 12.1 Operatorit donator nuk i lejohe të tarifoje parapaguesin për bartjen e numrit ose ndërprerjen e kontratës.
- 12.2 Operatorit pranues i lejohe të tarifoje parapaguesin. Kjo tarifë nuk mund të e jetë më e lartë se tre (3) euro për numrin e bartur.

**Neni 13**  
**Tarifat me shumicë ndërmjet operatorëve**

- 13.1 Çdo operator mbulon vet kostot e instalimit të sistemit të tyre për futjen e bartshmërisë së numrave në rrjetin e tij dhe përshtatjen e sistemeve operative.
- 13.2 Kostoja e instalimit për linjë ose numër bazohet në një proces efikas të bartshmërisë së numrit dhe mund të ngarkohet vetëm nga operatori donator tek operatori pranues pas miratimit nga ana e ARKEP.
- 13.3 Operatori i rrjetit origjinues kompenson operatorin, të cilit iu është caktuar blloku i numrave ose ndonjë operatori tjetër për koston përkatëse shtesë të një numri të bartur.
- 13.4 Rrjeti origjinues është rrjeti, në të cilin parapaguesi është i lidhur. Rrjeti origjinues është:
- a) në rast të parazgjedhjes dhe zgjedhjes së bartësit (carrier (pre)select), rrjeti i përzgjedhur;
  - b) në rast të thirrjeve ndërkombëtare: rrjeti i cili përmban portën (gateway) e lidhur me rrjetin ndërkombëtar;
- 13.5 Në vitin e parë, kostot vjetore të bazës qendrore dhe referues të të dhënave janë caktuar për operatorët e përmendur në paragrafin 7.1) në bazë të pjesës së tyre të tregut në të hyra në fund të vitit të kaluar.
- 13.5.1 Për vitet në vijim dhe pas konsultimeve të mëtejshme, ARKEP do të vendosë për të vazhduar me parimin e përcaktuar në pikën 13.5 apo të alokojë proporcionalisht kostot vjetore të shumës së numrave të bartur si donator dhe pranues.
- 13.5.2 ARKEP-i përcakton modalitetet praktike nëse paraqitet nevoja.

**KAPITULLI V**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 14**  
**Sanksionet Ekonomike**

- 14.1 Në rast se rregullat dhe dispozitat e kësaj rregullore nuk zbatohen nga operatorët, ARKEP-i mund të shqiptojë sanksione ekonomike, sipas nenit 101 të Ligjit.

**Neni 15**  
**Fillimi i zbatimit të Bartshmërisë së Numrave**

- 15.1 Bartshmëria e numrave për parapaguesit e telefonisë fikse do të fillohet të zbatohet pas hartimit të dokumentit/eve me specifikimet e nevojshme teknike të bazuara në standardet e ETSI të miratuar nga ARKEP.
- 15.2 Bartshmëria e numrave për parapaguesit e telefonisë mobile do të fillojë të zbatohet pas hartimit të dokumentit/eve me specifikimet e nevojshme teknike të bazuara në standardet e ETSI të miratuar nga ARKEP dhe implementimit të Projektit për Bartshmërinë e Numrave.
- 15.3 Data e fillimit të zbatimit të dispozitave nga paragrafet 15.1) dhe 15.2) do të caktohet nga ARKEP përmes një vendimi të veçantë.

**Neni 16**  
**Hyrja në fuqi**

- 16.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit me vendimin e Bordit të ARKEP.

**Prishtinë, 28/06/2017**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi**  
**Kryetar i Bordit**

**SHTOJCA I**  
**Letra e Autorizimit**

Numri(at) të cilët do të barten\_\_\_\_\_

Identifikimi i parapaguesit\_\_\_\_\_

Parametrat e nevojshëm në përputhje me specifikimet operacionale për validimin e kërkesës për bartshmërinë e numrit

Nënshkruesi, posedues i numrave të specifikuar më lartë, i jep këtë autorizim operatorit \_\_\_\_\_(operatori pranues) për bartjen e këtyre numrave në rrjetin e operatorit \_\_\_\_\_ (operatori pranues). Ky autorizim nënkupton se parapaguesi i jep mandat operatorit \_\_\_\_\_(operatori pranues) të ndërprej kontratën në emër të parapaguesit me operatorin \_\_\_\_\_(operatori donator).

Parapaguesi deklaron se ai do t'i përmbush të gjitha obligimet kontraktuale ndaj operatorit \_\_\_\_\_(operatorit donator).

Parapaguesi është i informuar se në rast:

- Të parapagmit mobil pre-paid, parapaguesi do të humb kreditin.
- Të vonesës ose abuzimit nga një operator, parapaguesi ka të drejtën e kompenzimit në përputhje me Rregulloren për Bartshmërinë e Numrave të miratuar nga ARKEP.

**Data:** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_

**Ky dokument është për periudhën 3 mujore nga data e nënshkrimit.**